



***Përgatitja e vlerësimit të Fazës II për ndërlidhjen ndërsektorale (NEXUS)
Ujë – Energji – Ushqim – Ekosisteme në Shqipëri***

3 qershor 2025
Tiranë, Shqipëri

Dokumenti konceptual dhe agenda

Organizuar nga:

**Global Water Partnership – Mediterranean
IDRA Research & Consulting**

Aktivitetet po zbatohen në kuadër të nën projektit 2.2 (“Zonat Bregdetare të Mesdheut: Menaxhimi i Ndërlidhjes NEXUS Ujë-Ushqim-Energji-Ekosisteme”), i cili është pjesë e një grupi prej 8 nën projektsh të ndërlidhura, që kontribuojnë në një qasje programore më të gjerë në Detin Mesdhe, të quajtur “Programi Med” (MedProgramme), i financuar nga Fondi Global për Mjedisin (GEF), me UN Environment/MAP si Agjencia Kryesore Zbatuese. Nën projekti 2.2 zbatohet nga Global Water Partnership – Mediterranean (GWP-Med). IDRA është kontraktuar për të udhëhequr zbatimin e aktiviteteve në Shqipëri. Më shumë informacion është i disponueshëm [këtu](#).

Agjencia zbatuese:



Mediterranean
Action Plan
Barcelona
Convention

Me mbështetjen e:



Përmbledhje mbi projektin dhe objektivat e takimit

Siç është identifikuar tashmë gjatë Fazës I, një ndër sfidat kryesore me ndikim dhe potencial të lartë ndërsektorial në Shqipëri është nevoja urgjente për rehabilitimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, dhe në veçanti e shumë rezervuarëve.

Objektivi i Vlerësimit të Ndërlidhjes NEXUS në Fazën II është të sigurojë:

- Një vlerësim të detajuar të mundësive për përfitim nga sinergjitë midis sektorëve të ndryshëm në rehabilitimin e një rezervuari dhe infrastrukturës përkatëse, në nivelin e një studimi fizibiliteti.
- Përgatitja e udhëzimeve dhe Planit të Veprimit për replikimin dhe zgjerimin e ndërhyrjeve të tilla në Shqipëri.

Në fokus të këtij projekti është rezervuari **Çorrush 1**, i cili gjendet në bashkinë Mallakastër. Ky rezervuar është ndërtuar në vitin 1967. Fillimisht është projektuar për të ujitur 480 hektarë, ndërsa aktualisht mund të përmbushë nevojat për ujitje vetëm për 200-250 hektarë. Analiza e zhvilluar gjatë fazës së parë të projektit evidentoi problematika të tilla si: *amortizimi i rrjetit ujitës dhe kullues, erozioni i trupit të digës, sedimentimi në rezervuar, etj.*

Objektivi kryesor i projektit është të vlerësojë mundësitë për të kthyer këtë rezervuar me një funksion të vetëm dhe kapacitet të kufizuar, në një rezervuar shumë-funksional. Nëpërmjet këtij studimi do të analizohen mundësitë për: *përmirësimin e sistemit ujitës dhe kullues, për zgjerimin e sipërfaqes së ujitur, rritjen e sigurisë së digës, modernizimin e infrastrukturës së shpërndarjes së ujit për ujite, identifikimin e përdorimeve të tjera të mundshme si prodhimi i energjisë ose zhvillimi i ekoturizmit etj.*

Zbatimi i projektit është strukturuar në tre faza kryesore:

Faza fillestare

- Identifikimi i rezervuarit në fokus (*aktivitet i përfunduar me përzgjedhjen e rezervuarit Çorrush 1*)
- Përgatitja e raportit fillestar (*aktivitet i përfunduar*)

Faza e zbatimit

- Organizimi i takimit të parë konsultativ me palët e interesit (*takimi aktual*)
- Mbledhja e të dhënave të detajuara
- Identifikimi i opsioneve të ndërhyrjeve
- Zhvillimi i propozimeve të detajuara
- Identifikimi i burimeve ose instrumenteve të mundshme të financimit
- Organizimi i takimit të dytë konsultativ me palët e interesit

Faza përfundimtare

- Finalizimi i Raportit të Vlerësimit të Fazës II
- Hartimi i Planit të veprimit

Për të diskutuar me më shumë detaje mbi gjetjet e fazës fillestare, si dhe për të marrë rekomandimet dhe sugjerimet tuaja, kemi kënaqësinë t'ju ftojmë në këtë takim, që ka për qëllim të evidentojë problematikat aktuale të rezervuarit Çorrush 1, si dhe nevojat dhe mundësitë për ndërhyrje.

Draft agjenda për takimin mbi projektin
“Përgatitja e vlerësimit të Fazës II për ndërlidhjen ndërsektoriale (NEXUS)
Ujë – Energji – Ushqim – Ekosisteme në Shqipëri”

Data: 03.06.2025

Koha: 11:00 – 12:30

Vendi: Tirana International Hotel & Conference Centre (salla VIP)

Koha	Tema	Pikat kryesore
11:00 - 11:10	Kafe mirëseardhjeje dhe regjistrim Hapja e takimit	• Prezantimi i pjesëmarrësve
11:10 - 11:20	Objektivat e projektit dhe përzgjedhja e rezervuarit në fokus	• Përmbledhje e objektivave të projektit • Kriteret e përzgjedhjes së rezervuarit në fokus
11:20 - 11:35	Gjetjet nga faza fillestare	• Prezantimi i gjetjeve nga faza fillestare e projektit
11:35 - 11:55	Diskutim mbi ndërhyrjet potenciale	• Diskutim mbi mundësitë për ndërhyrje dhe përmirësime • Rekomandime nga palët e interesit
11:55 - 12:15	Diskutim mbi të dhënat e nevojshme	• Identifikimi i të dhënave dhe informacionit të nevojshëm • Diskutim mbi të dhënat e disponueshme nga palët e interesit
12:15 - 12:30	Përmbledhje dhe hapat e mëtejshëm	• Rishikimi i detyrave për fazën e ardhshme